

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6443  
E martë, 19 tetor 2021  
çmimi 0.40 €

## Kurti për zgjedhjet lokale: Jemi të kënaqur me rezultatin e arritur

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

VLERËSOHET MBARËVAJTJA E PROCESIT TË ZGJEDHJEVE LOKALE TË 17 TETORIT

# KOSOVA MERR LËVDATA PËR ORGANIZIM TË ZGJEDHJEVE



Kosova ka marrë lëvdata për mbarëvajtjen dhe organizimin e raundit të parë të zgjedhjeve lokale. Vëzhguesit ndërkombëtarë dhe vendorë kanë vlerësuar se procesi zgjedhor i së dielës është zhvilluar në mënyrë të qetë dhe pa ndonjë incident. Ndërsa njohësit e rrethanave politike në vend kanë theksuar se Kosova vazhdon të mbetet kampione në rajon për organizimin e zgjedhjeve të lira

FAQE 4-5

## VOTË PËR PROGRAM E JO PËR PARTI

FAQE 7



## INICIOHEN 95 RASTE PËR HETIM RRETH TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

FAQE 3

### AKTUALE



VDES ISH-SEKRETARI I SHTETIT, COLIN POWELL F. 2

KOSOVA DERI MË TANI ADMINISTRON 1.5 MILION VAKSINA KUNDËR COVIDIT F. 3

META TAKON GËRVALLËN: SHQIPËRIA DHE KOSOVA DUHET TË BASHKËPUNOJNË PËR LEHTËSIMIN E ÇDO PENGESË F. 3

### EKONOMI



AUDITIMI, SPANCA: GJENDJE E RËNDUAR VAZHDON TË JETË NË NDËRMARRJET PUBLIKE F. 8

NË 2022-N TERMINALET DOGANORE SHTETËRORE PRITET TË SHTRIHEN NË TË GJITHË VENDIN F. 8

### SPORT



DRITA NË KRIZË REZULTATESH, NUHIU DHE AJZERAJ: PËR FITORE NDAJ FERONIKELIT F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht--Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.PK.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
030-500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Vdes ish-sekretari i Shtetit, Colin Powell

WASHINGTON, 18 TETOR - Ish-sekretari amerikan i Shtetit, Colin Powell, ka vdekur në moshën 84-vjeçare nga komplikimet e shkaktuara si pasojë e Covid-19, ka njoftuar familja e tij. Powell ka qenë ish-oficer i lartë ushtarak dhe i pari afrikano-amerikan që u emërua sekretar i shtetit.

Emërimi i tij ishte bërë në vitin 2000 kur president i ShBA-së ishte George W. Bush. “Ne kemi humbur një burrë, baba, gjysh dhe një amerikan të mrekullueshëm dhe të dashur. Ne duam të falënderojmë stafin mjekësor për trajtimin e kujdesshëm”, thuhet në

deklaratën e familjes. Powell ka qenë një këshilltar ushtarak i besueshëm i një numri të madh të politikanëve kryesorë amerikanë. Ai, gjithashtu, ka shërbyer në luftën e Vietnamit, një përvojë që më vonë e ndihmoi për përcaktimin e strategjive të tij ushtarake dhe politike.



## Opozita hungareze bashkohet për ta sfiduar Orbanin

BUDAPEST, 18 TETOR - Një kryetar konservator i një qyteti hungarez është zgjedhur për ta sfiduar kryeministrin Viktor Orban në zgjedhjet e vitit të ardhshëm. Peter Marki-Zay, pa përkatësi partiake, u zgjodh nga ana e opozitës për të kandiduar për kryeministër në zgjedhjet e ardhshme hungareze.

Ai tani do të udhëheqë një opozitë të bashkuar në zgjedhjet parlamentare.

Hulumtimet e opinionit tregojnë se ai e ka një mundësi të mirë për të rrëzuar



kryeministrin e krahut të djathtë, partia e të cilit Fidesz, është në pushtet që nga viti

2010. “Ne nuk duam vetëm ta zëvendësojmë Orbanin dhe partinë e tij, por duam një

Hungari të re, më të pastër dhe më të ndershme”, u tha Marki-Zay mbështetësve të zgëzuar në Budapest.

Marki-Zay, 49 vjeç, një praktikues i fesë katolike dhe baba i shtatë fëmijëve, fitoi karshi kundërshtares së tij nga qendra e majtë, Klara Dobrev. Ajo i siguroi atij mbështetjen në zgjedhje.

Për shumë vite partia Fidesz e Orbanit ka përfituar nga përçarjet brenda partive opozitare. Por, për herë të parë që kur erdhi në pushtet, Orban tani do të përballet me një

front të bashkuar të partive opozitare, në të cilin përfshihen socialistët, liberalët dhe ish e djathta ekstreme, Jobbik.

Në një deklaratë, Fidesz tha se rivali i tyre është një “majtist i karrierës”.

Qeveria konservatore e Orbanit është kritikuar disa herë për trajtimin që ua bënë migrantëve, por edhe për ngecjet në sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut përfshirë ato të komunitetit LGBT+ (homoseksual, lesbike, biseksual dhe transgjinnor).

## Stoltenberg: NATO-ja do të fokusohet më shumë në rritjen e Kinës

BRUKSEL, 18 TETOR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, i ka thënë të përditshmes britanike “Financial Times” se luftimi i ndikimit politik dhe ushtarak të Kinës do të jetë në fokus të aleancës ushtarake në të ardhmen.

Ky kthim drejt Kinës shënon një drejtim të ri për NATO-n dhe vjen teksa blloku perëndimor riorienton strategjinë drejt Azisë. “Kur është fjala për forcim të mbrojtjes sonë të përbashkët, aty përfshihet edhe çështja se si të përballemi me rritjen e Kinës”, ka thënë Stoltenberg për

“Financial Times”, në një intervistë të publikuar më 18 tetor. “Ajo çfarë mund të parashikojmë është se rritja e Kinës do të ndikojë në sigurinë tonë. Veçse ka ndikuar”, ka shtuar ai.

NATO-ja është fokusuar tradicionalisht në luftim të ndikimit të Rusisë dhe pas sulmeve të 11 shtatorit të vitit 2001, edhe në terrorizëm.

Mirëpo tani pasi aleanca ka përfunduar misionin e vet 20-vjeçar në Afganistan, Stoltenberg ka thënë se më shumë vëmendje duhet të ketë ndikimi gjeopolitik i Pekinit në



Amerikën Veriore dhe Evropë. “Kina po na afrohet... Ne e shohim atë në Arktik. E shohim në hapësirë kibernetike. E shohim edhe duke investuar tejet shumë në infrastrukturë kritike në shtetet tona”, ka thënë Stoltenberg.

“Financial Times” ka raportuar më 16 tetor se Pekini ka testuar një raketë hipersonike me kapacitetet bërthamor në muajin gusht.

Ky vendim ka zënë në befasi zyrtarët amerikanë të inteligjencës dhe ka treguar se Kina ka shënuar përparim më të shpejtë sesa është pritur në gjeneratën e re të armëve.

## Mianmari do të lirojë mbi 5 000 të burgosur

NEPXHIDOU, 18 TETOR - Mianmari, shtet i njohur edhe si Burma, ka thënë se do të lirojë më shumë se 5 000 persona të cilët janë burgosur gjatë protestave kundër puçit të muajit shkurt. Mijëra persona janë ndaluar gjatë protestave të përgjakshme, pasi liderët ushtarakë kanë marrë pushtetin.

Lideri i Mianmarit, gjenerali Min Aung Hlaing, ka thënë se 5 636 të burgosur do të lirohen për arsye humanitare.

Ky vendim është marrë pasi ky



gjeneral është përjashtuar nga një samit vjetor i liderëve rajonalë, të cilët kanë thënë se ushtria nuk ka bërë mjaftueshëm për t’iu dhënë fund trazirave.

Asociacioni i Kombeve të Azisë Juglindore është pajtuar për të ftuar një përfaqësues jopolitik nga Mianmari, në vend të gjeneralit Min Aung Hlaing.

Të paktën 1 178 persona janë vrarë dhe mbi 7 000 janë arrestuar janë akuzuar apo dënuar në kuadër të fushatës për shtypje të kundërshtarëve, pas rrëzimit nga

pushteti të Aung San Suu Kyi, ka thënë Asociacioni për të Burgosurit Politikë.

Gjenerali Aung Hlaing ka thënë se të burgosurit do të lirohen për të shënuar një festë budiste më vonë gjatë muajit tetor.

Shefi ushtarak ka thënë se liderët e shtetit janë të përkushtuar për paqe dhe demokraci. Ai ka thënë se qeveria e tij e ka planin me pesë hapa për ta rikthyer demokracinë. Autoritetet kanë liruar më shumë se 2 000 protestues kundër puçit në muajin korrik.

# Kosova deri më tani administron 1.5 milion vaksina kundër Covidit

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 TETOR - Ministria e Shëndetësisë ka bërë me dije të hënën se deri më tani në Kosovë janë administruar 1.5 milion vaksina kundër Covid-19. Kjo ministri ka theksuar se derisa përballemi me variantin shumë ngjitës 'Delta' të Covid-19, ndryshimi nuk do të vijë nëse nuk punojmë të gjithë së bashku për t'u vaksinuar.

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se vaksinimi është mbrojtja më e mirë që kemi: "Asgjë nuk ka mbaruar ende. Vaksinat e sigurta dhe efektive kundër Covid-19 janë në dispozicionin tuaj".

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se, sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, prej 1 419 testeve, një qytetar ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes nga Covid-19. Të hënën janë shëruar edhe 42 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 156 936.

Në total numri i rasteve aktive me Covid është 632.

Në Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës, bazuar në raportet e datës 18 tetor, si pasojë e Covid-19, të shtirë për tretman mjekësor janë 71 pacientë, prej tyre 34 me oksigjeno-terapi dhe katër

në mjekim intensiv mjekësor, në gjendje të rënduar shëndetësore.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka theksuar përmes një njoftimi se situata epidemiologjike me Covid

vazhdon me rënie të numrit të rasteve të reja pozitive dhe numrit të vdekjeve por, megjithatë, situata është akoma jostabile duke pasur parasysh se varianti 'Delta' është i pranishëm dhe është varianti dominues në qarkullim

në Kosovë. "IKShPK-ja apelon te të gjithë qytetarët për respektimin e të gjitha masave sipas vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Për shkak të rrezikshmërisë së lartë të përhapjes së Covid-19, bëjmë thirrje për kujdes dhe

mosgrumbullim.

Rekomandojmë institucionet përgjegjëse të mbikëqyrin me përpikëri dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për parandalimin dhe luftimin e pandemisë", është thënë në mesazhin e IKShPK-së.



## Meta takon Gërvallën: Shqipëria dhe Kosova duhet të bashkëpunojnë për lehtësimin e çdo pengese



TIRANË, 18 TETOR (ER) - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka pritur të hënën në takim zëvendëskryeminstren dhe ministren e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës së Republikës së Kosovës, Donika Gërvalla. "Zhvillimi i zgjedhjeve lokale, nxjerrja si dhe pranimi i rezultateve paraprake nga të gjitha palët në proces, është një shembull për të gjithë rajonin se si duhet të zhvillohen dhe administrohen zgjedhjet", ka shkruar Meta në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka treguar se në këtë takim ka theksuar nevojën që Shqipëria dhe Kosova të bashkëpunojnë edhe më ngushtësisht për lehtësimin e çdo pengese që ekziston në zhvillimet në fushën politike, kulturore, ekonomike, tregtare dhe të gjitha sferat e tjera të jetës. "Të dyja vendet tona së bashku duhet të punojnë për forcimin dhe konsolidimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës si dhe për përsheptimin e proceseve të integritimit evropian", ka shkruar Meta.

## Ish-komandanti i FSK-së jep dorëheqje nga strukturat e PDK-së


PRISHTINË, 18 TETOR (ER) - Ish-komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Kadri Kastrati, ka dhënë dorëheqje nga të gjitha strukturat e Partisë

Demokratike të Kosovës (PDK). Ai ka thënë se do të mbetet çdoherë i gatshëm t'i shërbejë Kosovës në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes pa qenë anëtar i ndonjë subjekti

politik. "Ju njoftoj se sot kam dhënë dorëheqje nga të gjitha strukturat e Partisë Demokratike të Kosovës. Unë do të mbetem çdoherë i gatshëm t'i shërbej vendit tim

në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, kurdo që të më kërkohet një gjë e tillë, por pa qenë anëtar i ndonjë subjekti politik", ka shkruar Kastrati në llogarinë e vet në "Facebook".





VLERËSOHET MBARËVAJTJA E PROCESIT TË ZGJEDHJEVE LOKALE TË 17 TETORIT

# Kosova merr lëvdata për organizim të zgjedhjeve

Kosova ka marrë lëvdata për mbarëvajtjen dhe organizimin e raundit të parë të zgjedhjeve lokale. Vëzhguesit ndërkombëtarë dhe vendorë kanë vlerësuar se procesi zgjedhor i së dielës është zhvilluar në mënyrë të qetë dhe pa ndonjë incident. Ndërsa njohësit e rrethanave politike në vend kanë theksuar se Kosova vazhdon të mbetet kampione në rajon për organizimin e zgjedhjeve të lira

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 18 TETOR** - Misioni Ndërkombëtar i Rrjetit Evropian të Organizatave Monitoruese të Zgjedhjeve (ENEMO) ka vlerësuar se raundi i parë i zgjedhjeve lokale në Kosovë është zhvilluar në një atmosferë të qetë.

Në një konferencë për media, shefi i këtij misioni, Pierre Peytier, ka paraqitur raportin e gjetjeve dhe konkluzioneve preliminare në lidhje me zhvillimin e raundit të parë të zgjedhjeve lokale të 17 tetorit. "Zgjedhjet e së dielës janë mbajtur në mjedis të qetë edhe përkundër tensioneve që kanë qenë në veri të Kosovës dhe

diskutimeve për mundësinë e shtyrjes së tyre për shkak të situatës me Covid-19. Vonesat e vazhdueshme për kryerjen e reformave zgjedhore kanë çuar në pikën ku rregullat janë të paqarta, gjë që kjo ndikon edhe në sigurinë juridike", ka thënë ai. Peytier ka bërë me dije se incidentet e vogla nuk kanë ndikuar në procesin zgjedhor. "Misioni nuk ka vëzhguar në mënyrë gjithëpërfshirëse, por në disa vende si në Prishtinë, Graçanicë, Kishnicë dhe Mitrovicë të Veriut. Incidentet e vogla nuk kanë ndikuar në procesin e zgjedhjeve", ka deklaruar ai.

Kurse Elene Nizharadze, zëvendës shefe e këtij misioni, ka përmendur disa sfida të procesit

zgjedhor. "Normat ekzistuese zgjedhore nuk janë të mjaftueshme për të siguruar informacione dhe, po ashtu, kjo ndikon në qasjen për të votuar nga ana e personave me nevoja të veçanta. Legjislacioni është gjithashtu i paqartë sa iu përket afateve për ankesa në lidhje me procesin zgjedhor", ka deklaruar ajo.

Edhe vëzhguesit vendorë e kanë vlerësuar lart mbarëvajtjen e zgjedhjeve lokale në Kosovë. "Procesi i sotëm i votimit është zhvilluar në mënyrë të qetë, me pjesëmarrje të qytetarëve që garanton legjitimitet të procesit. Më 17 tetor nuk është raportuar për ndonjë incident që do të mund ta cenonte integritetin apo kredibilitetin e zgjedhjeve",

është thënë në komunikatën për media të Demokracisë në Veprim, e cila ka monitoruar procesin zgjedhor.

Kursen njohësit e rrethanave politike në vend kanë vlerësuar se Kosova ka organizuar fushatë zgjedhore dhe zgjedhje të shkëlqyeshme. Sipas tyre, populli, partitë dhe institucionet e Kosovës po u japin shkollë vendeve të rajonit dhe me gjerë për organizim të zgjedhjeve.

Gazetari Adriatik Kelmendi ka deklaruar se Kosova edhe një herë ka treguar se ka popull të mrekullueshëm. "Prej Athine e deri në Helsinki jemi shkollë për zgjedhje. Kosova edhe një herë tregoi se ka sovran, se ka popull të mrekullueshëm, që i sofistikon edhe vetë politikanët. Fushatë shembullore, me ditë zgjedhore të shkëlqyeshme. As fjalë të rënda nuk ka pasur në fushatë, asnjë akuzë qenësore për manipulim nga politikanët. Plus të mbështetura nga mediat më të mira në rajon. Shkojmë edhe me raundin e dytë. S'ka lëshim në

cilësi!", ka shkruar Kelmendi në profilin e vet në "Facebook".

Edhe politologu Agon Maliqi për organizim të zgjedhjeve e ka krahasuar Kosovën me vende skandinave. "Sovran më simpatik nuk ka në Ballkan. Në fakt, gati-gati jemi bërë skandinavë për nga zgjedhjet", ka shkruar Maliqi në profilin e vet në "Facebook".

Ndërsa Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka vlerësuar se Kosova mbetet kampione e organizimit të zgjedhjeve të lira. "KMDLNj shpreson se edhe balotazhi do të shkojë pa asnjë problem dhe, në këtë mënyrë, Kosova do ta ruajë primatin e vendit shembullor për organizim dhe mbajtjen e zgjedhjeve të lira, që nga fushata parazgjedhore e deri te dita e votimit sikur edhe koha pas certifikimit të rezultateve në bazë të të cilave edhe ndërtohen institucionet që dalin nga ato zgjedhje. Është e arritur e madhe për Kosovën, një shtet që ende po e bën

→ shtetndërtimin, të organizojë zgjedhje e që lirisht mund të merren si model për shtetet e rajonit dhe, në një mënyrë, në këtë drejtim po krahasohet me shtetet që e kanë një demokraci shumë më të konsoliduar dhe më të qëndrueshme”, është thënë në njoftimin e KMDLNJ-së.

### Vetëvendosja nuk ka fituar asnjë komunë në raundin e parë

Partia që qeverisë vendin, Lëvizja Vetëvendosje (LV), nuk ka arritur të fitojë asnjë komunë në raundin e parë të zgjedhjeve lokale. Rezultatet preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kanë treguar se në raundin e parë vetëm partitë opozitare kanë fituar komuna. Sipas këtyre rezultateve, të dielën janë zgjedhur kryetarët e 17 komunave, ndërkaq në balotazh do të shkojnë 21 komuna.

LV-ja në balotazh, i cili do të mbahet më 14 nëntor, do të përballet me kandidatët e të gjitha partive.

Në Prishtinë kandidati i LV-së, Arben Vitia, do të përballet me kandidatin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Përparim Rama, i cili doli i dyti në këto zgjedhje.

Në Gjakovë kandidatja e LV-së, Mimoza Kusari-Lila, do të garojë kundër kryetarit të deritanishëm, Ardian Gjinit nga AAK-ja. Në Prizren, Mytaher Haskuka i LV-së do të garojë në balotazh me kandidatin e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Shaqir Totaj.

Në balotazh me PDK-në, LV-ja do të jetë edhe në Shtime.

Në Podujevë Shpejtëm Bulliqi i LV-së është në garë me Ekrem Hysenin e LDK-së.

LV-ja do të synojë fitore në

balotazh edhe në Gjilan, me kandidatin Alban Hyseni, i cili do të përballet me kryetarin e deritanishëm, Lutfi Hazirin e LDK-së.

Këto dy parti në raundin e dytë do të garojnë edhe në Fushë-Kosovë dhe Viti.

LV-ja është në balotazh edhe në Obiliq, Kamenicë, Rahovec dhe Kaçanik.

### PDK-ja fiton katër komuna, LDK-ja fiton Pejën dhe Lipjanin

Sipas rezultateve preliminare të KQZ-së, fituese të këtyre zgjedhjeve janë konsideruar partitë opozitare. Partia Demokratike e Kosovës ka fituar katër komuna pa balotazh. Në Mitrovicën e Jugut, Bedri Hamza ka mposhtur Agim Bahtirin e LV-së. Në Ferizaj ka fituar sërish Agim Aliu, derisa PDK-ja ka arritur ta rikthejë bastionin e saj, Skenderaj, ku kandidati Fadil Nura ka mposhtur kryetarin aktual Bekim Jasharin.

Kandidati i PDK-së në Hanin e Elezit, Mehmet Ballazi, ka arritur ta mposhtë kryetarin e deritanishëm të kësaj komune, kandidatin e pavarur Rufki Suma. Kjo parti do të garojë në balotazh në Prizren, Malishevë, Drenas, Klinë, Vushtri, Shtime, Dragash dhe Kaçanik.

Lidhja Demokratike e Kosovës ka arritur t'i fitojë sërish komunat në të cilat ka qeverisur. Gazmend Mahaxheri në Pejë dhe Imri Ahmeti në Lipjan, fituan në komunat ku qeverisnin.

LDK-ja në balotazh do të jetë në Prishtinë, Podujevë, Gjilan, Viti, Fushë-Kosovë, Istog dhe në Dragash.

Kurse Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në raundin e parë ka arritur të fitojë në Suharekë dhe Deçan.

# Kurti për zgjedhjet lokale: Jemi të kënaqur me rezultatin e arritur

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 18 TETOR - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, që njëherësh është kryeministër i Kosovës, ka thënë të hënën se është i kënaqur me rezultatin e shënuar në zgjedhjet lokale të mbajtura më 17 tetor. Partia e Kurtit, sipas rezultateve preliminare, në raund të parë nuk ka fituar asnjërin prej 38 komunave, por në raundin e balotazhit do të garojë në 12 komuna. “Jemi të kënaqur me këtë që kemi arritur për shkak se edhe në nivel vendi sa iu përket zgjedhjeve lokale, Vetëvendosja u bë subjekti i parë”, ka thënë Kurti në një konferencë për media.

Kurti iu referua votës së fituar në nivel vendi gjatë zgjedhjeve lokale të 17 tetorit. Ai shtoi se partia e tij kurrë nuk ka qenë “më e fortë”, pasi theksoi se Lëvizja Vetëvendosje është subjekti i parë edhe në nivel qendror dhe lokal. Megjithatë, ai theksoi se zgjedhjet parlamentare dhe ato lokale nuk

Kjo parti në balotazh do të garojë në Gjakovë, Rahovec, Junik dhe Klinë.

Partia serbe, Lista Serbe, ka fituar më së shumti komuna në këto zgjedhje lokale. Kjo parti ka arritur të fitojë në plot nëntë komuna, të cilat janë të banuara me shumicë serbe.

Pa balotazh Lista Serbe ka fituar në Leposaviq, Zubin Potok,



mund të krahasohen.

Në zgjedhjet e fundit parlamentare të 14 shkurtit 2021, Lëvizja Vetëvendosje doli e para, duke fituar mbi 50 për qind të votave. Sipas Kurtit, para qytetarëve “imazhi i Lëvizjes Vetëvendosje është më i fortë për çështjet nacionale”. Kurti shtoi se në balotazh do të synojnë që të fitojnë në të gjitha komunat që garojnë dhe shprehu bindjen e tij se në Prishtinë, kandidati i kësaj partie, Arben Vitia, do të fitojë. “Unë shpresoj, por edhe besoj

që Arben Vitia do të jetë kryetar i kryeqytetit dhe më 15 nëntor do ta marrë detyrën aty ku duhet dhe ku kanë thënë edhe qytetarët e kryeqytetit”, ka deklaruar Kurti.

Raundi i balotazhit, sipas ligjeve në fuqi, duhet të mbahet katër javë pas raundit të parë. Kurti ka thënë se zgjedhjet lokale ishin të lira, fer dhe demokratike dhe Kosova po bëhet shembull në rajon për mbajtjen e zgjedhjeve. Në zgjedhjet e 17 tetorit pjesëmarrja në zgjedhje ishte rreth 43 për qind.

Zveçan, Mitrovicë të Veriut, Graçanicë, Novobërdë, Shtërpçë, Ranillug dhe Partesh.

Lista Serbe është në balotazh vetëm në një komunë, në Klokot, me iniciativën qytetare SNS (Srpska narodna sloga). Në balotazh do të jetë edhe komuna e banuar me shumicë turke, Mamusha.

Sipas Ligjit për Zgjedhjet Lokale,

raundi i dytë i zgjedhjeve ndërmjet dy kandidatëve, të cilët kanë fituar më së shumti vota të vlefshme, mbahet ditën e diel, katër javë pas raundit të parë.

Në zgjedhjet e kaluara lokale të vitit 2017, nga gjithsej 38 komuna, në 19 prej tyre fituesit janë ditur në raundin e parë, ndërsa 19 komuna të tjera kishin shkuar në balotazh.

## Fillon të dëgjohet dëshmitari i parë në gjykimin ndaj Guçatit dhe Haradinajt në Hagë

HAGË, 18 TETOR - Në Dhomat e Specializuara në Hagë ka nisur dëgjimi i dëshmitarit të parë në gjykimin ndaj ish-kryerëve të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Guçati e Nasim Haradinaj.

Zenka Pumper është dëshmitarja e parë e Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe ajo është koordinatore e hetimit në këtë zyrë.

Zenka Pumper ka thënë se është pjesë e ZPS-së prej vitit 2016 dhe puna e saj është të intervistojë dëshmitarë, analizojë prova, të shkruar raporte dhe të përgatisë plane të punës. “Kam qenë e përfshirë në një punë goxha të konsiderueshme lidhur me këtë çështje. Unë kam koordinuar kontrollin, kërkimin që ka ndodhur në OVL-UÇK dhe kam



koordinuar kërkimin pra, kam përpunuar një pjesë të mirë të provave, kam raportuar kontrollin e kryer dhe kam rishikuar një pjesë të

konsiderueshme të materialit, në veçanti ato materiale të cilat janë sekuestruar nga OVL-UÇK, të cilat përmenden në paketën 1,2 dhe 3 si dhe materialin i cili na

është dorëzuar nga organi mediatik”, ka thënë ajo derisa u është përgjigjur pyetjeve të prokurores Valeria Bolici.

Në fillim të seancës, kryetari i trupit

gjyqes, Charles L. Smith, III, ka pyetur Guçatin dhe Haradinajn nëse dëshirojnë të bëjnë ndonjë deklaratë, por ata nuk e kanë bërë një gjë të tillë derisa Guçati ka deklaruar se do të deklarohet në një seancë tjetër.

Gjykimi ka vazhduar paraqitjen e disa dokumenteve si prova nga ana e prokurorisë, por që të njëjtat nuk bëhen me dije për publikun.

Ish-kryerët e OVL-UÇK-së akuzohen për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, konkretisht për pengim të personave zyrtarë për kryerjen e detyrave zyrtare, për frikësim të dëshmitarëve, për hakmarrje dhe për shkelje të fshehtësisë së procedurës. Ata janë arrestuar më 25 shtator të vitit 2020 në Prishtinë prej kur edhe mbahen në qendrën e paraburgimit në Hagë. (ksp)

# Inicohen 95 raste për hetim rreth trafikimit të qenieve njerëzore

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 18 TETOR** - Ministria e Punëve të Brendshme ka shënuar 18 tetorin, Ditën e BE-së kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Ky aktivitet u hap nga koordinatori nacional kundër trafikimit të qenieve njerëzore, njëherësh zëvendësministër i MPB-së, Blerim Gashani.

Ai me këtë rast ka falënderuar për praninë përfaqësuesit e ICITAP-it, Këshillit të Evropës, OSBE-së, GIZ-it, Terresdes Hommes dhe donatorëve të tjerë, si dhe anëtarët e Autoritetit Kombëtar për përkushtimin, angazhimin e tyre dhe punën rreth planifikimit të kampanjës njëmuajore kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Me këtë rast zëvendësministri Gashani ka thënë se rishtazi është bërë publik edhe raporti i GRETA-s, raporti i dytë i përputhshmërisë së Kosovës me standardet e Konventës së Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

“Sot kur po takohemi së bashku, para jush zotohem se do të punojmë në përmbushje të rekomandimeve, jo vetëm të këtij raporti, por edhe të gjitha raporteve me rëndësi të veçantë për ne, siç është edhe TIP raporti

i ShBA-së, në mënyrë që ta sigurojmë pajtueshmërinë e plotë me standardet evropiane dhe ndërkombëtare në luftën kundër trafikimit të njerëzve dhe për mbrojtje dhe mbështetje të plotë për viktimat e trafikimit në të gjitha nivelet e referimit të tyre”, ka theksuar Gashani, duke shtuar se në këtë drejtim Kosova e ka të ndërtuar kornizën ligjore dhe institucionale. “Parandalimi dhe luftimi i trafikimit të qenieve njerëzore ka qenë dhe mbetet prioritet. Megjithatë, duke marrë parasysh që ky është një fenomen transnacional që në vazhdimësi sjell sfida në spektrin global, ne do të vazhdojmë të punojmë së bashku me partnerët tanë ndërkombëtarë”, ka thënë ai.

Në këtë ceremoni Gashani ka thënë se pandemia me Covid-19 ka krijuar sfida në menaxhim gjithëpërfshirës të pandemisë, specifikisht ka prekur edhe veprimet në fushën e parandalimit dhe luftimit të trafikimit dhe, gjithashtu, trajtimit të viktimave. “Raportet ndërkombëtare tregojnë që trafikuesit kanë përfituar nga kjo krizë dhe gjendja e dobët ekonomike e krijuar si rezultat i pandemisë dhe është shënuar rritje e trafikimit për keqpërdorim seksual sidomos nëpërmes internetit (rrjeteve



sociale) si pasojë e mbylljes dhe kufizimit të lirisë së lëvizjes”, është shprehur Gashani.

Ai ka thënë se nga pozicioni i koordinatori do të bëjë të pamundurën në përkrahje dhe inicim të proceseve, të cilat ndikojnë në parandalim dhe luftim të trafikimit të qenieve njerëzore, gjithashtu proceseve që sigurojnë mbrojtjen dhe trajtimin e duhur të viktimave. Zëvendëshefi i Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, Tankut

Soykan, ka thënë se e vlerëson zotimin e koordinatori nacional për përmbushje të rekomandime të dala nga raporti i dytë i GRETA-s dhe pret me padurim që këto rekomandime të zbatohen në praktikë.

Ndërsa drejtori i Drejtorisë për Hetimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Policinë e Kosovës, Fehmi Gjata, ka bërë me dije se gjatë periudhës janar-shtator të këtij viti janë iniciuar 95 raste për

hetimin në dyshim për trafikim të qenieve njerëzore dhe vepra të tjera që ndërlidhen me trafikim.

Ai ka thënë se janë iniciuar 139 persona të dyshuar për TQNJ dhe vepra që lidhen me trafikim. “Janë identifikuar 15 viktimat të trafikimit, është shkatërruar një grup kriminal me gjithsejtë tetë persona, janë realizuar 22 plane operative, ku janë kontrolluar 114 objekte të ndryshme”, ka thënë Gjata.

## Organizohet punëtori për përfshirje të komunitetit joshumicë në Policinë e Kosovës

**PRISHTINË, 18 TETOR (ER)** - Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal dhe mbështetur nga OSBE-Misioni në Kosovë, me qëllim të rritjes së përfshirjes së komunitetit joshumicë në Policinë e Kosovës, ka ftuar të gjithë të interesuarit që të aplikojnë për pjesëmarrje në “Punëtorinë për përfitim e njohurive për procedurat e aplikimit, testimit dhe procedurave të tjera të nevojshme për aplikim si zyrtar policor”.



Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka njoftuar se ky projekt ka për qëllim që të

ofrojë mundësinë e ndjekjes së punëtorisë parapërgatitore, për 100 të rinj, vajza dhe djem, për

t'i motivuar që të aplikojnë si kadetë të Policisë së Kosovës, duke synuar në mënyrë specifike komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës. “Të përzgjedhurit do ta ndjekin punëtorinë në Akademinë Kosovare për Siguri Publike dhe do të akomodohen në AKSP gjatë punëtorisë parapërgatitore.

Inkurajojmë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret si në vijim, të dërgojnë CV-në dhe shprehjen e interesimit, jo më vonë se më 24 tetor në mpb.trajnimet@rks-gov.net. Të

interesuarit duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës. Të kenë të përfunduar shkollën e mesme. Të jenë të moshës 18-30 vjeç. Dëshminë e vaksinimit (apo PCR test). Punëtorja do të mbahet nga data 27 tetor 2021, në Akademinë Kosovare për Siguri Publike. (Data e trajnimit mund të zhvendoset varësisht nga masat e marra lidhur me Covid-19). Vetëm pjesëmarrësit të cilët i përmbushin kriteret e përcaktuara më lart, do të kontaktohen për pjesëmarrje në punëtori”, ka njoftuar MPB-ja.

## Fillojnë punën zyrtarët e rinj policorë në Prizren

**PRIZREN, 18 TETOR (ER)** - Në Drejtorinë Rajonale të Policisë në Prizren kanë filluar punën 12 zyrtarë të rinj policorë nga gjenerata e 56 e Policisë së Kosovës. Me këtë rast drejtori rajonal, kolonel Faton Alija, së bashku me stafin komandues, gjatë inspektimit, i ka uruar

mirëseardhje duke i siguruar mbështetje dhe përkrahje zyrtarëve policorë të rinj. Zyrtarët e rinj policorë fillimisht do të kryejnë një trajnim fushor në stacionin policor në Prizren, pastaj do të punojnë në njësi profesionale varësisht nga nevojat e

Policisë së Kosovës. Policia e Kosovës ka njoftuar se vazhdimisht është duke u ngritur profesionalisht, andaj ka theksuar se së shpejti do të hapë konkurs për zyrtarë të rinj policorë, duke inkurajuar gjininë femërore, minoritetet dhe të tjerët.



# Votë për program e jo për parti



Një ditë pas zgjedhjeve lokale dhe publikimit të rezultateve preliminare, qytetarët kanë deklaruar se kanë votuar për programin dhe jo për partitë dhe kandidatët. Por ata thonë se, pavarësisht se kush ka fituar në cilëndo komunë, në përgjithësi nuk presin që të realizohen premtimet e dhëna nga kandidatët

**PRISHTINË, 18 TETOR** - "Gënjeshtrave më nuk u besojmë" dhe "votuaam për programin, jo për partinë apo kandidatin". Këto janë vlerësimet e para të disa qytetarëve në Prishtinë, të anketuar nga "Radio Evropa e Lirë", një ditë pas zgjedhjeve lokale dhe publikimit të rezultateve preliminare. Partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje (LV), sipas rezultateve preliminare, nuk ka arritur të fitojë në asnjë komunë të Kosovës në zgjedhjet lokale derisa do të garojë në balotazh në 12 komuna.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka fituar katër komuna pa balotazh. Në Mitrovicën e Jugut, Bedri Hamza ka mposhtur Agim Bahtirin e LV-së, i cili për tetë vjet ishte kryetar i kësaj komune. Në Ferizaj ka fituar sërish Agim Aliu, derisa PDK-ja ka arritur ta rikthejë bastionin e vet,

Skenderajn. Fadil Nura mundi kryetarin e Skenderajt, Bekim Jasharin, që ishte kandidat i pavarur.

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka arritur të fitojë sërish komunat në të cilat ka qeverisur. Gazmend Mahaxheri në Pejë dhe Imri Ahmeti në Lipjan, fituan në komunat ku qeverisin.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka arritur të fitojë në Suharekë dhe Deçan, komuna këto të qeverisura nga kjo parti. Bali Muharremaj në Suharekë dhe Bashkim Ramosaj në Deçan, fituan pa balotazh.

Partia serbe, Lista Serbe, ka fituar më së shumti komuna në këto zgjedhje lokale.

Kjo parti ka arritur të fitojë në nëntë komuna të cilat janë të banuara me shumicë serbe.

Rezultatit e zgjedhjeve lokale të një dite më parë, qytetarët e kanë parë si një ndryshim pozitiv për

komunat dhe vendin në përgjithësi. Sipas tyre, qytetarët kanë arritur që përfundimisht të votojnë për programet politike dhe jo për subjektet apo kandidatët që kanë garuar.

Arnisa Kryeziu nga Prishtina me profesion arkitekte, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se qytetarët me votën e tyre po tregojnë saktë se çfarë ndryshimesh duan. "Unë fillimisht duke hedhur një paralele edhe prej zgjedhjeve qendrore që ishin, ajo ka qenë një shenjë për mua shumë e mirë, që ne veç kemi filluar të kërkojmë atë që duam. Zgjedhjet lokale i kam pritur pak më ndryshe, jam befashuar në disa raste. Mirëpo, çka është e mirë është se njerëzit po duan më të mirën për qytetin pa marrë parasysh kush është kandidati ose cilës parti i takon, që është gjë e mirë dhe do të thotë kemi nevojë për ndryshime në qytete dhe në përgjithësi", ka thënë ajo. Ridvan Turbetari, ekonomist, thotë se pavarësisht asaj se kush ka fituar në cilëndo komunë, në përgjithësi nuk pret që të realizohen premtimet e dhëna nga kandidatët. Megjithatë, ai thotë se ndryshimet janë të nevojshme kudo. "Te zgjedhjet lokale ka ndryshime. Besoj se personi i cili është kandidat

ndikon te rezultatet", u shpreh ai. Kurse Orhan Llapashtica, tregtar, thotë se qytetarët nuk janë duke pranuar më premtimet, që ai i cilëson si të kota. "Tash, vetë qytetarët po zgjedhin. Kjo është pika e fundit. Gënjeshtrat e politikanëve nuk po i hamë më. Na pëlqen, mirë, nuk na pëlqen, nuk po e votojmë dhe u krye biseda", u shpreh Llapashtica. Muhamet Brajshori thotë se qytetarët kanë ditur se kë ta votojnë dhe, sipas tij, votat e tyre nuk duhet të shkojnë huq. "Vendimet me votën e qytetarëve i kam parë të arsyeshme, mirë është. Kanë votuar në mënyrë të mençur", thotë ai.

Bukureza Demolli shprehet se këto zgjedhje janë një tregues i mirë që qytetarët nuk kanë votuar për subjektet politike, por për programet. "Mendoj se kemi ndryshuar dhe nuk është se po shohim partitë politike, por veç programet se çka po planifikojnë të bëjnë për vendin apo komunën. Mendoj se është më mirë se herën e kaluar", ka theksuar ajo.

Edhe Rozafa Kryeziu, studente, mendon ngjashëm. "Po mendoj se me këtë njerëzit po duan të ndryshojnë sepse është parë ajo që një parti një komunë e ka pasur për disa vjet, e tash po

duan të shohin diçka ndryshe nga partitë e tjera, jo gjithmonë njëjtë", është shprehur Kryeziu. Vigjilenca Islami thotë se qytetarët kanë ndryshuar shumë, janë vetëdijesuar dhe tash duan përmirësimin e jetës së tyre në të gjitha komunat. "Mendoj se kështu do ishte dashur të ishte përherë, jo të votojnë për partinë, jo për personin, por për planprogramin dhe atë çfarë pritet të arrihet, sepse aty e kemi nevojën, do të thotë ndryshimin, inovacioni, e këto", ka thënë Islami.

Sipas rezultateve preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, 21 komuna të Kosovës duhet ta zhvillojnë raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar.

Zgjedhjet lokale në Kosovë janë mbajtur më 17 tetor dhe 17 komuna kanë zgjedhur kryetarët e tyre për mandatin e radhës në raundin e parë.

Sipas Ligjit për Zgjedhjet Lokale, nëse asnjëri nga kandidatët nuk fiton më shumë se 50 për qind të votave, plus një votë të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme, atëherë KQZ-ja duhet të organizojë raundin e dytë mes dy kandidatëve që kanë fituar më së shumti vota. Sipas këtij ligji, raundi i dytë mbahet katër javë pas mbajtjes së raundit të parë.

# Auditimi, Spanca: Gjendje e rënduar vazhdon të jetë në ndërmarrjet publike

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHINË, 18 TETOR** - Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, kryesuar nga Hykmete Bajrami, kryetare, ka mbajtur të hënën mbledhjen e radhës, në të cilën të pranishëm ishin ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati dhe auditorja e

përgjithshme e ZKA-së, Vlora Spanca.

Në prezantimin e raportit vjetor të auditimit për vitin 2020, auditorja Spanca ka shpalosur të gjeturat e këtij raporti, i cili brenda vetes ngërthen 90 raporte, 12 auditime publike, si dhe 11 auditime të performancës.

Spanca ka theksuar se sa iu përket të gjeturave, gjendje më e rënduar

është dhe vazhdon të jetë në ndërmarrjet publike.

Më pas, kryetarja e komisionit, Bajrami, ka adresuar disa nga çështjet të cilat ajo i konsideron si më problematike, ndër të cilat ishte moszbatimi i platformës E-Pasuria si dhe nevoja imediate për rishikimin e pasqyrave financiare.

Në vazhdim, ministri Murati, pasi u përgjigj në pyetjet e parashtruara

nga anëtarët e komisionit, ka theksuar se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka përgatitur një plan me 38 rekomandime të cilat ndërlidhen me llogaridhënien dhe transparencën.

Në pyetjen lidhur me projektin e rrugës Kijevë - Sahaq, ministri Murati ka thënë se gjatë implementimit të këtij projekti kanë hasur në keqpërdorime të shumta

sa i përket shpronësimit dhe se tani është duke u punuar intensivisht për rishikim të projektit në fjalë.

Mbledhja u mbyll me dakordimin që deri më 20 tetor anëtarët e komisionit t'i dërgojnë rekomandimet e tyre të dala nga shqyrtimi i raportit vjetor 2020, në mënyrë që në mbledhjen e ardhshme të bëhet miratimi final i tyre.



## Pushteti lokal në Shqipëri për nëntë muaj ka arkëtuar 35.3 milionë euro më shumë se vitin e kaluar

**TIRANË, 18 TETOR** - Bashkitë në Shqipëri kanë mbledhur më shumë të ardhura për nëntëmuajorin e këtij viti duke tejkaluar edhe nivelet e para të krizës. Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, pushteti vendor ka arkëtuar për këtë periudhë 21 miliardë lekë nga taksat, rreth 4.3 miliardë lekë apo 35.3 milionë euro më shumë se një vit më parë.

Në raport me vitin 2019 të ardhurat për bashkitë u rritën rreth 16.4 milionë euro, ku peshën më të madhe gati gjysmën e tyre e mbajnë të ardhurat që pushteti vendor siguron përmes taksës së ndikimit në infrastrukturë mbi ndërtesat e reja, që vijon të

ndikojë pozitivisht ecurinë e të ardhurave, pasi edhe në pjesën e parë të vitit lejet e ndërtimit kanë parë një rritje të konsiderueshme. Më shumë para janë mbledhur edhe për taksën e pasurisë dhe atë mbi ndërtesat për nëntëmuajorin pasi totali i tyre arriti në 4.9 miliardë lekë të ardhura, nga 3.9 miliardë lekë arketime që u mbledhën për të njëjtën periudhë të 2020-s.

Referuar statistikave, rritje kanë shënuar edhe arkëtimet nga taksat lokale me 15.8 miliardë lekë të grumbulluara deri në fund të shatorit, rreth 28 milionë euro më shumë se kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë, kur pandemia dha edhe ndikim të konsiderueshëm.



## Në 2022-n terminalët doganorë shtetërorë pritet të shtrihen në të gjithë vendin

**PRISHINË, 18 TETOR (ER)** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, bashkë me ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, takuan drejtorin e Doganës së

Kosovës, Agron Llugaliu, ndërsa tha se deri në mesin e vitit të ardhshëm terminalët doganorë shtetërorë shtrihen në të gjithë vendin.

Në njoftimin për media thuhet se


drejtori Llugaliu e njoftoi kryeministrin Kurti për nënshkrimin e marrëveshjes me "Trepça Sh.A." për rikthimin e terminalit doganor shtetëror në hapësirat e Trepçës në Mitrovicë

dhe ndikimet pozitive që kjo do të ketë. Më tej thuhet se u dakorduan që deri në mesin e vitit të ardhshëm në gjithë territorin e vendit të shtrihen terminalët doganorë shtetërorë.





# Suksesi i vaksinave mRNA ndaj Covid-19, i hap rrugën një gjenerate të re ilaçesh kundër tumoreve



## Nga Nikou ASGARI

Në vitin 2017, Vinod Balashandran botoi një studim në revistën shkencore "Nature", duke shpjeguar një fenomen interesant që ai kishte zbuluar mbi një numër të vogël të mbijetuarish nga kanceri pankreatik.

Qelizat T që qarkullonin në gjakun e tyre, kishin zhvilluar aftësinë për të identifikuar, kujtuar dhe luftuar kundër proteinave që gjenden në tumoret vdekjeprurëse. Kirurgu i Qendrës së Kancerit "Memorial Sloan Kettering" në Nju Jork, e krahasoi atë proces me "auto-vaksinën". Balashandran përshkroi në studim mënyrën se si duke përdorur molekulat e ARN-së mesazheve, vaksinat aktuale mund të përdoren për të përsëritur reagimin imunitar, dhe për të forcuar aftësinë e shumë pacientëve për të mbrojtur veten kundër tumoreve që kanë shpesh pasojë fatale.

Hulumtimi i tij i bëri përshtypje një shkencëtarit pak të njohur në atë kohë, Ugur Shahin, kreu ekzekutiv i kompanisë gjermane të bioteknologjisë "BioNTech". Ai u intrigua aq shumë nga ky zbulim sa që e ftoi ekipin e Balashandran në selinë e kompanisë së tij në Mainz.

Gjatë darkës në Heiligeist, një kishë gati 800-vjeçare e shndërruar në restorant buzë brigjeve të lumit Rin, bashku me shkencëtarët e kompania farmaceutike zvicerane "Genentech", ata diskutuan mbi potencialin e vaksinave mRNA për të trajtuar kancerin e pankreasit. Shkalla e mbijetesës tek pacientët

me kancerin e pankreasit është e ulët. Sipas Shoqërisë Amerikane të Kancerit, vetëm 10 për qind mbijetojnë më shumë se sa 5 vjet, duke e bërë atë një nga format më vdekjeprurëse të sëmundjes. Sa për krahasim, 90 për qind e pacientëve me kancerin e gjirit, mbijetojnë gjatë së njëjtës periudhë kohore.

Dy vite kërkime pasuan darkën e asaj mbrëmjeje, dhe në dhjetorin e vitit 2019, 20 pacientë u regjistruan në testin e parë klinik që vlerësonte ndikimin e vaksinave mRNA tek pacientët me kancer pankreatik. Por kur u shfaq koronavirusi, "BioNTech" dhe shumë kompani të tjera e drejtuan punën e tyre me mRNA tek zhvillimi i një vaccine kundër Covid-19.

Ndërsa vaksinat mRNA të kompanive "BioNTech/Pfizer" dhe "Moderna" janë bërë të famshme, pasi e kanë reduktuar në mënyrë dramatike numrin e vdekjeve nga Covid-19, Balashandran është një nga shkencëtarët që po vazhdojnë ta përdorin këtë teknologji mjekësore për të eksploruar trajtimet për sëmundje të tjera.

Përkrahësit e teknologjisë mRNA, thonë se lufta ndaj Covid-19 është vetëm fillimi, dhe se përdorimi i saj më i gjerë paralajmëron një revolucion të vërtetë në mjekësinë moderne. Kurat për disa forma të kancerit, janë ndër disa nga fushat që po eksplorohehen.

Tani kompanitë farmaceutike po i kushtojnë vëmendje fuqisë së mRNA, për të trajtuar një sërë sëmundjesh, nga gripi tek sëmundjet e zemrës dhe HIV. Ndërkohë, po zhvillohen testet e para të vaksinave mRNA kundër

virusit Zika, etheve të verdha dhe sëmundjeve të rralla si acidemia metilmalonike, kur trupi nuk është në gjendje të zbërthejë proteinat.

"Pesë vjet më parë kompanitë më të mëdha hezitoinin të investonin në këtë fushë. Por fakti që kaq shumë njerëz po vaksinohen me vaksinat mRNA anti-Covid, ka sjellë një ndryshim të madh"-thotë Majkell Çoi, kreu i shkencave të jetës në "Boston Consulting Group".

Suksesi i vaksinave ndaj Covid-19, e ka transformuar pikëpamjen shkencore dhe tregtare mbi këtë teknologji. Asnjë produkt me bazë mRNA, nuk ishte miratuar më parë entet rregullatore, deri në shfaqjen e pandemisë aktuale.

"Kjo është shpesh një kombinim midis nevojës mjekësore dhe realizueshmërisë"- thotë Shahin mbi mënyrën sesi kompania e tij ka zgjedhur sëmundjet që synon të shërojë. Fokusi i "BioNTech" ka qenë gjithmonë zhvillimi i vaksinave të individualizuara, të përshtatura enkas për të sulmuar kanceret specifike, një qasje për të cilën Shahin, një onkolog në profesion, beson se do të shënojë një revolucion në trajtimin e këtyre sëmundjeve.

Kompania e tij ka nisur ndërkohë testet me ilaçet për trajtimin e kancerit të zorrëve, gjirit, lëkurës etj. Edhe prodhuesit e tjerë të ilaçeve, përfshirë kompaninë "Moderna" po studiojnë gjithashtu zhvillimin e vaksinave të personalizuara të kancerit duke përdorur mRNA.

Ata shpresojnë të trajtojnë sëmundjet që janë ndër shkaqet kryesore të vdekjeve në të gjithë

botën, dhe njëherazi të futen në tregun e onkologjisë që vlen qindra miliarda dollarë. Sipas kompanisë "McKinsey", volumi i shitjeve të terapive të kancerit parashikohet të arrijnë në 250 miliardë dollarë deri në vitin 2024, nga 143 miliardë dollarë në vitin 2019.

Vaksinat terapeutike kundër kancerit, synojnë të stimulojnë një përgjigje imune kundër tumoreve ekzistues, në vend se të parandalojnë sëmundjet, siç bën për shembull vakcina e gripit. Ato janë të përshtatura për mutacionet specifike në tumorin që ka pacienti.

Shkencëtarët heqin indet nga tumori përmes një biopsie, dhe më pas sekuencojnë mutacionet e gjetura në qelizat e kancerit. Gjetjet krahasohen me ADN-në në gjakun e pacientit, dhe më pas përdoren algoritmet për të parashikuar se cilat proteina specifike do të nxisin një përgjigje më të fortë imunitare. Më pas këto proteina kodohen në një molekulë mRNA, e cila formon bërthamën e vaksinës së kancerit. Pasi të injektohet në trup, udhëzimet e bartura në vaksinën mRNA u thonë qelizave të trupit që të zbërthejnë proteina të caktuara, të cilat e trajtojnë sistemin imunitar të njohë mutacionet në qelizat e kancerit si agjentë të huaj, dhe më pas t'i sulmojë dhe shkatërrojë ato qeliza.

"Ne e nisëm këtë punë në vitin 2014, dhe koha nga mostrës së tumorit deri tek zhvillimi i vaksinës ishte rreth tre muaj, por tani me procesin e automatizimit më duhen më pak se 6 javë"-thotë Shahin. Vaksinat ekzistuese kundër kancerit synojnë kryesisht

virusin që shkakton kancerin, sesa vetë tumorin.

Në SHBA, vakcina ndaj HPV jo-mRNA u jepet vajzave që në moshën 9-vjeçare për t'i mbrojtur kundër kancerit të qafës së mitrës, që mund të shkaktohet nga papillomavirusi njerëzor. Por përtej kancerit, testet me mRNA janë duke u zhvilluar edhe për sëmundje të ndryshme infektive. Studimet mbi vaksinat e gripit, pritet të prodhojnë rezultate më të shpejta. Një sëmundje infektive siç është Covid-19 ose gripi, ndryshon me kalimin e kohës, ndaj vaksinat duhet të përditësohen çdo vit për llojet e reja.

Vaksinat ekzistuese të gripit përdorin versione të çaktivizuara të virusit, dhe sigurojnë 40-60 për qind mbrojtje, pasi që nga koha kur është prodhuar vakcina dhe deri sa administrohet ajo, ndodh shpesh që virusi të ketë pësuar mutacione.

Shpresohet që mRNA, e cila mund të përshtatet më shpejt, do të rrisë në mënyrë dramatike efikasitetin e vaksinave kundër gripit sezonal. Megjithatë, pavarësisht optimizimit dhe përparimeve me këtë teknologji gjatë pandemisë së Covid-19, do të duhen vite para se testet në disa fusha të nisin të prodhojnë rezultate, dhe ilaçet të miratohen nga entet rregullatore. Këto të fundit në të gjithë botën i përshpejtuan proceset e miratimit të tyre gjatë pandemisë për shkak të nevojës urgjente për një vaksinë, por kjo është një shpejtësi që nuk ka gjasa të përsëritet për ilaçet e tjera.

Marrë me shkurtime nga "Financial Times" – Bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Drita në krizë rezultatesh, Nuhiu dhe Ajzeraj: Për fitore ndaj Feronikelit

Trajneri Ardian Nuhiu dhe futbollisti Almir Ajzeraj kanë paralajmëruar se skuadra e Dritës do t'u rikthehet fitoreve që nga ndeshja kundër Feronikelit e cila zhvillohet sot (e martë) me fillim nga ora 13:00. "Mendoj se skuadra në ndeshjen e radhës do të reflektojë. Kemi nevojë për një rezultat të mirë dhe tri pikët e plotë", ka thënë Nuhiu

**EPOKA ERE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 18 TETOR** - Nënkampionia e Kosovës në futboll ka hyrë në një krizë të thellë rezultatesh pasi në pesë ndeshjet e fundit nuk ka shijuar asnjë fitore, derisa nga nëntë ndeshjet e zhvilluar në këtë kampionat ka regjistruar gjithsejtë tri fitore, katër barazime dhe dy humbje. Kjo skuadër sot (e martë) do të përballet me skuadrën e Feronikelit.

Trajneri Ardian Nuhiu ka thënë se skuadra e tij do ta japë maksimumin për ta marrë maksimumin e pikëve ndaj "Niklit" në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas. "Tri ditë më tepër jemi përkushtuar të punojmë në aspektin psikologjik sesa në atë taktik. Të martën na pret një përballje mjaft e fortë ngaqë kemi një kundërshtar i cili ka në përbërje futbollistë që e njohin mirë kampionatin dhe deri tani kanë ecur mirë. Futbollistët janë gati të japin edhe më tepër se maksimumin për ta marrë maksimumin. Jam i bindur se djemtë do të sakrifikojnë gjithçka për atë që duam të marrim. Mendoj se skuadra në ndeshjen e radhës do të reflektojë. Kemi nevojë për një rezultat të mirë dhe tri pikët e plotë", ka thënë Nuhiu.

Krahas trajnerit Nuhiu, në konferencë për media i pranishëm ishte edhe futbollisti Almir Ajzeraj. Futbollisti i talentuar ka thënë se çdo ndeshje është e rëndësishme për Ditën, ndërsa rezultateve pozitive skuadra do t'u kthehet në ndeshjen ndaj Feronikelit. "Çdo ndeshje është e rëndësishme dhe mendoj se periudhën e rezultateve të këqija



tashmë e kemi kaluar dhe nga e marta besoj se do të rikthehemi te fitorja. Ekipi është i përgatitur, stërvitet kanë shkuar mirë dhe besoj se nga nesër do të rikthehemi. Sa iu përket rezultateve të deritanishme, ka qenë një ngërç psikologjik, kemi stërvitur shumë dhe tashmë janë rikthyer edhe futbollistët e lënduar dhe tashmë jemi më të kompletuar. Prandaj nga nesër besoj se do të krijojmë, rrezikojmë e shënojmë më shumë, sepse loja e mirë nuk na ka munguar dhe shpresoj të rikthehemi aty ku e kemi vendin te rezultatet e mira dhe fitoret", ka deklaruar Ajzeraj. Në ndeshjen e radhës Drita do të ketë mungesën e Arbnor Mujës, i cili është

i lënduar. Feronikeli renditet në pozitën e shtatë me 10 pikë, kurse Drita është e katërta me 13 pikë. Sot zhvillohen edhe dy ndeshje të tjera. Do të takohen Prishtina - Malisheva dhe Ulpiana - Llapi.

## SUPERLIGA - JAVA 10

**Të martën takohen:**  
13:00 Feronikeli - Drita  
13:00 Ulpiana - Llapi  
13:00 Prishtina - Malisheva

**Të mërkurën takohen:**  
13:00 Dukagjini - Ballkani  
13:00 Gjilani - Drenica

## SHKURT

### Kreshnik Ukaj, 'ylli i javës' në Superligë

Federata e Futbollit e Kosovës së bashku me sponsoren e Superligës, Bankën Kombëtare Tregtare BKT Kosova, vazhdojnë ta ndajnë çmimin "Ylli i javës" për lojtarin më të mirë të xhiros. Sulmuesi 26-vjeçar Kreshnik Uka është ndër më të merituarit për rezultatet pozitive të ekipit kuqezi nga Skenderaj si me lojën e shfaqur, po ashtu edhe me golat. Ukaj shënoi 2 gola në ndeshjen e javës së 9-të që skuadra e tij e mposhti FC Feronikelin. Me këtë fitore Drenica u rikthye në pozitën e liderit në Superligë. Çmimin "ylli i javës" për sulmuesin e skuadrës së Drenicës e dorëzoi Fatos Rushiti, menaxher i degës së BKT në Skenderaj.

### Më 26 tetor, Llapi - Kosova Dusseldorf

Në organizim të Federatës së Futbollit të Kosovës, më 26 tetor do të zhvillohet ndeshja revyale ndërmjet fituesit të Kupës së Kosovës, Llapit dhe fituesit të Kupës së Diasporës, Kosova Dusseldorf. Ndeshja do të zhvillohet në stadiumin me bari sintetik në Ferizaj, me fillim në orën 14:00. Ky aktivitet është i hapur për të gjitha mediat si dhe për tifozët.

### Mula, trajneri i përkohshëm i Vëllaznimit

Skuadra e Vëllaznimit nga Gjakova me anë të një njoftimi ka zyrtarizuar trajnerin e ri të skuadrës. Koordinatori i Akademisë së Klubit nga Gjakova, Blerim Mula, sot është emëruar përkohësisht trajner i skuadrës. Kujtojmë se para disa ditëve ish-trajneri Granit Begolli dha dorëheqje nga kuqezinjtë. "KF Vëllaznimi e uron për postin Blerim Mulën dhe i dëshiron suksese në vazhdim", thuhet në njoftimin e klubit kuqezi.

### Spalletti: Rrahmani e ka fituar me meritë vendin e titullarit

Napoli e ka mposhtur të dielën Torinon me rezultat minimal 1-0. Trajneri Luciano Spalletti e ka lavdëruar mbrojtësin e Kosovës, Amir Rrahmani, i cili ka treguar një formë fantastike. "Rrahmani është një lojtar që e ka fituar me meritë vendin e titullarit. Është një lojtar me nivel të lartë. Amiri është një mbrojtës i kompletuar, është e vështirë ta giesh anën e dobët të tij sepse ai ka pozicionim të mirë, fizik, ndikim në lojë dhe është një djalë i disponueshëm në çdo rast", ka thënë Spalletti.

## 'Dardanet' U19 luan ndeshjen e parë në kualifikimet për 'Euro2022'

**PRISHTINË, 18 TETOR** - Përfaqësuesja e Kosovës U19 në konkurrencën e femrave ndodhet në Poreç të Kroacisë ku do t'i zhvillojë ndeshjet kualifikuese për Kampionatin Evropian 2022. Pas suksesit të arritur me Përfaqësuesen U17, ku arriti që nga Liga B të kalojë në Ligën A të kualifikimeve, përzgjedhësi Kushtrim Munishi

tani synon që një sukses të tillë ta arrijë edhe me Përfaqësuesen U19. Të hënën "Dardanet" U19 e kanë mbajtur stërvitjen e dytë në Poreç, teksa sot (e martë) do ta zhvillojnë duelin e parë ku do të përballen me Letoninë në orën 11:00. Më pas futbollistët e Kosovës do të takohen me Lihtenshtajnin më 22 tetor derisa ndeshjen e fundit e luajnë

kundër Kroacisë më 25 tetor. Kalimin në Ligën A (raundi i dytë kualifikues) e siguron ekipi që renditet i pari, derisa tutje kalon edhe ekipi më i mirë i vendit të dytë nga të gjashtë grupet e Ligës B. Përfaqësuesja e Kosovës në këto kualifikime përbëhet nga 20 lojtare, 14 prej të cilave janë nga kampionati vendor dhe 6 nga klubet evropiane.



## Federeri, jashtë top dhjetëshes

CYRIH, 18 TETOR - Pas përfundimit të turneut Masters të Indian Wells është publikuar renditja e re botërore në tenis. Serbi Novak Djoković e australianja Ashleigh Barty qëndrojnë në krye të renditjes

pavarësisht se nuk kanë luajtur në këtë turne. Ajo që bie në sy është zbritja në vendin e 11-të e zviceranit Roger Federer, që del nga "Top-10" më të mirët në botë. Te femrat zbrit në vendin e dhjetë tenisista japoneze

Naomi Osaka, që nuk ka luajtur shumë muajt e fundit. Rënditje e meshkujve: Novak Djoković (11.430 pikë), Daniil Medvedev (9.630), Stefanos Tsitsipas (7.995), Alexander Zverev (6.930), Rafael Nadal

(5.635). Rënditje e femrave: Ashleigh Barty (9.077 pikë), Aryna Sabalenka (7.115), Karolina Pliskova (5.320), Barbora Krejčíková (4.748), Garbine Muguruza (4.096).



## Ylli shkëlqen edhe në Superkupën Mbarëkombëtare



PRISHTINË, 18 TETOR - Golden Eagle Ylli ka fituar Superkupën Mbarëkombëtare, duke mundur Sigal Prishtinën me rezultat 76:67 (17:16, 23:14, 15:18, 21:19). Fillimi i ndeshjes ishte i barabartë dhe kjo u karakterizua gjatë gjithë çerekut të parë, ku asnjëra skuadër nuk arrinte të shkëputej në rezultat dhe kjo pjesë përfundon 17:16. Skuadra nga Theranda ishte më e mirë në periudhën e dytë, duke qenë

efikase në sulm dhe me mbrojtje të fortë arriti që të ketë epërsi deri në 13 pikë, 40:27, ndërsa pjesa e parë përfundoi me rezultat 40:30. Therandasit ishin në epërsi edhe gjatë periodës së tretë, duke e kontrolluar lojën, për të qenë në epërsi konstante, kurse prishtinasit nuk arrinin ta afrojnë rezultatit. Pas një loje të barabartë, rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 55:48. Prishtina nuk u dorëzua dhe

ngushtoi shifrat në 67:63, por pa arritur të bëjë më shumë dhe Golden Eagle Ylli triumfoi me rezultat 76:67. Kupën kapitenit të Golden Eagle Yllit, Gëzim Morina, ia dorëzoi kryetari i Bordit të Ligës Unike, Ilir Trebicka. MVP u shpall Mikaile Tmusiq, ndërsa çmimin ia dorëzoi drejtori i Ligës Unike, Dren Zatriqi. Më herët Ylli ka fituar Ligën Unike, dy trofetë e deritashëm në këtë garë.

## Besa humbet në Banjallukë, pas një jave e synon përmbysjen e rezultatit në Pejë

PEJË, 18 TETOR - Kampionia e Kosovës në hendboll, Besa Famgas, ka zhvilluar ndeshje të madhe ndaj Borcit në Banjallukë të Bosnjë-Hercegovinës, të dielën mbrëma. Ndeshja u fitua 28:25 nga Borci vendas por, megjithatë, paraqitja e pejanëve u vlerësua. Ishte ndeshja e parë e raundit të dytë të Kupës Evropiane për hendbollistë. Gjatë gjithë kohës tifozët e skuadrës vendase kanë fyer shqiptarët, duke bërë madje edhe thirrje për vrasjen e tyre. Por lojtarët e Besës kanë ruajtur qetësinë, janë shfaqur profesionalë dhe kanë luftuar deri në fund. Ndeshja ishte shumë e barabartë, ndërsa në aksionet e fundit Borci është shkëputur në tri gola. Ndeshja e kthimit zhvillohet pas një jave në Pejë, ndërsa Besa Famgas e synon përmbysjen e rezultatit dhe



avancimin në raundin e tretë të Kupës Evropiane. Paraqitja në Banjallukë jep shumë shpresë për rezultat pozitiv në "Karagaçi". Të gjithë lojtarët që u aktivizuan kanë dhënë më të mirën, ndërsa janë shquar reprezentuesit e

Kosovës. Më efikas ishte Nikola Prce me 7 gola. Gjashtë gola i shënoi Egzon Gjuka, ndërsa pesë i kishte Deniz Terziqi. Nga tre gola i shtuan Kastriot Jupa e Arbios Mushkolaj. Me pritje në portë është shquar Mursel Mehmeti.

### SHKURT

#### Buttoni: Do të shohim të tjera aksidente mes Hamiltonit dhe Verstappenit

Piloti britanik Jenson Button, ish-kampion bote në Formula 1, ka parashikuar të tjera incidente në pistë mes Lewis Hamiltonit (Mercedes) e Max Verstappenit (Red Bull). "Unë mendoj se në Monza fajin më të madh e kishte Max, pasi e mbylli shumë shpejt derën. Ndërsa në aksidentin e ndodhur në Silverstone ishte Hamiltoni ai që gaboi dhe ishte fajtor për kontaktin. Është e qartë se asnjëri prej tyre nuk heq këmbën nga gazi. Për pasojë, kjo është ajo që ndodh në pistë, ku aksidenti është i pashmangshëm", ka thënë Button. "Dyshoj se aksidenti në Monza do të jetë i fundit, pasi ka ende gjashtë gara deri në fund dhe diferenca mes dy pilotëve është e vogël. Kam frikë se deri në fund do të shohim edhe ndonjë përplasje tjetër, pasi secili dëshiron të përfitojë nga çdo centimetër në pistë", ka shtuar Button.

#### Allegri: Roma e meritoi barazimin

Trajneri Massimiliano Allegri ka thënë se Roma e ka merituar barazimin në ndeshjen që "Zonja e Vjetër" e fitoi me rezultat 1-0. "E vërteta, Roma do të kishte merituar plotësisht barazimin, por episodet ecën të gjitha në favorin tonë. Futbolli është një lojë e çmendur, sepse ndaj Romës na i dha vetëm Szczesny tri pikët më me peshë deri tani, pikërisht ai Szczesny që na bëri të humbim pikë të rëndësishme në fillim, por që konfirmoi cilësitë e tij dhe faktin se ai meriton të gjithë besimin tonë", ka thënë Allegri. "Pastaj, kur gabojmë është faji i të gjithë skuadrës, jo vetëm i individit, ndonëse sërish, kur arrijmë në tri metrat e fundit të portës rivale, vazhdojmë të gabojmë shumë. Kjo ishte një fitore e madhe, ndeshja e tretë radhazi e madhe, në të cilën nuk pësojmë gol", ka deklaruar Allegri.

#### Edhe Benitezi refuzon Newcastle

Rafael Benitezi refuzon rikthimin në stolin e Newcastle, duke iu shtuar listës së gjatë të trajnerëve që nuk dëshirojnë t'i bashkohen projektit të arabëve te "qymyrxhinjtë". Në një intervistë trajneri spanjoll është shprehur se ndihet mirë te Evertoni dhe as që e mendon largimin, duke përjashtuar çdo mundësi për t'u rikthyer te Newcastle. "Tifozëve të Newcastle United u uroj çdo të mirë sepse marrëdhënia ime me ta është e mirë dhe shpresoj që të jetë përgjithmonë, por tani për tani jam i lumtur këtu duke u përpjekur për të bërë më të mirën time. Nuk më pëlqen të flas për opsione të tjera sepse vërtet dua të jem aty ku jam. Ndiem shumë komod te Evertoni dhe më pëlqen puna në këtë klub", ka thënë Benitezi.

#### 23 gara në 35 javë në Formula 1

Federata Ndërkombëtare e Automobilizmit ka zyrtarizuar kalendarin e garave të vitit 2022 në Formula 1. Në total do të jenë 23 gara, rekord në këtë sport, po aq sa ishin parashikuar edhe këtë vit (do të zhvillohen 22 gara). Gara e parë do të zhvillohet më 20 mars, në Bahrein dhe e fundit më 20 nëntor, në Abu Dhabi. Pra, do të garohet për 35 javë. "Jemi të kënaqur nga ky kalendar. Shpresojmë që vitin tjetër të kemi sa më pak probleme me pandeminë", ka thënë Stefano Domenicali, presidenti i Formula 1. Vitin tjetër nuk do të garohet në Kinë dhe Turqi, ndërkohë që do të zhvillohen dy gara në Itali dhe Amerikë, ku debuton pista qytetase e Majemit. Natyrisht që muaji gusht do të jetë pushim.

## Rudigeri vendos të largohet nga Chelsea

Antonio Rudiger nuk do ta rinovojë kontratën me Chelsea për t'u larguar si futbollist i lirë në përfundim të këtij sezoni. Rudiger nuk

ndihet plotësisht i vlerësuar te Blutë e Londrës dhe ua ka komunikuar drejtuesve të klubit se dëshiron të provojë përvojë të re në një tjetër

kampionat. Me shumë gjasë e ardhmja e ish-mbrojtësit të Romës do të jetë në La Liga aty ku ka arritur një parakontratë me Realin e Madridit,

ndërkohë që për Rudigerin interesohet edhe PSG-ja që i ka bërë një ofertë, por që mbrojtësi me shumë gjasë do të refuzojë t'i bashkohet

projektit të klubit merengues. Reparti ku ka më shumë nevojë për përforcime Real i Madridit është qendra e mbrojtjes.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Lika Company" Sh.p.k. Miradi e Ulët Fushë Kosovë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

**DEBAT PUBLIK**

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën për prodhimin e asfaltit në Miradi e Ulët Fushë Kosovë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 11.11.2021 në ora 10:00 Restorantin " Vera" Vragoli, Fushe Kosove, rruga kryesore Prishtine - Peje, afer Pompes se derivateve IP do të organizohet debat publik nga Kompania " Lika Company" Sh.p.k. Miradi e Ulët Fushë Kosovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazë për prodhimin e asfaltit në Miradi e Ulët, Fushë Kosovë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/9569794308?pwd=YXozRHRIaXdHUTdXT2tzUWduTFRDdz09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Lika Company" Sh.p.k. Miradi e Ulët, Fushë Kosovë për bazë për prodhimin e asfaltit në Miradi e Ulët Fushë Kosovë.

[https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet\\_dhe\\_publicimet/279/publikimet](https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publikimet)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Sh.m.e "Gjin Gazulli"

SH.M.L."GJIN GAZULLI" NË PRISHTINË

Nr. prot. 2082

Datë: 19.10.2021

**TENDER**

Me të cilin ftohen kompanitë e interesuara që të konkurrojnë për furnizimin e nxënësve të shkollës sonë me uniforma shkollore unike.

Ofertuesi duhet të paraqesë këto dokumente të nevojshme:

1. Certifikatën e regjistrimit të veprimtarisë përkatëse.
2. Çmimi i uniformës.
3. Referencë e ushtrimit të veprimtarisë së tillë.

Oferta mbetet e hapur 7 ditë prej shpalljes së saj në mjetet e informimit publik. Të interesuarit, ofertat i dorëzojnë drejtpërdrejt në shkollë.

Prishtinë, më 19.10.2021



Nga komisioni



**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**RESTAURANT**

**SWISS**

**TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- ▶ Bleta Boshnjaku shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- ▶ Bernardina Alijaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I, II, III,IV dhe diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi" drejtimi Farmaci Gjakovë.
- ▶ Xhevdet Dervishaj nga Nasheci i Prizrenit, shpall të pavlefshme Diplomën e studimeve themelore universitare të lëshuar nga Kolegji "Dardania", drejtimi: Banka, Financa dhe Kontabilitet.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



ROYAL CROWN



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

